




PRISHTINA 2035

PLATFORMA ZGJEDHORE

Hajrulla Çeku



Përmbajtja

Prishtinë që funksionon	6
Kryeqytet i zhvilluar	8
Prishtina që garanton barazi	10
Sektorët prioritarë gjatë mandatit të parë	13
Trafiku - Prishtina 2035	13
Transporti publik	17
Menaxhimi i mbeturinave	21
Zhvillimi ekonomik lokal	25
Zhvillimi rural	29
Turizmi	32
Siguria publike	36
Hapësirat publike	40
Shërbimet në lagje	44
Sektorët e tjerë Prishtina 2035	48
Administrata dhe qeveria	48
Planifikimi hapësinor	50
Mjedisi	52
Shëndeti publik	55
Arsimi	58
Banimi	61
Arti dhe kultura	63
Sporti dhe aktiviteti fizik	66
Trashëgimia kulturore dhe qendra historike	69
Mirëqenia sociale	71
Transparenca dhe llogaridhënia	74
Përmbledhje e përgjithshme	76

Të dashur qytetare dhe qytetarë të Prishtinës,

Prishtina ka nevojë për një transformim të gjithanshëm.

Një qytet nuk është vetëm ndërtesa e asfalt. Një qytet është përditshmëria e banorëve të tij, është mundësia për zhvillim, është barazia për secilin.

Prishtina e sotme përballet me shumë sfida – papastërti, trafik të ngujuar, lagje të lëna pas dore, ekonomi të dobët, mungesë transparence. Këto probleme të shtresëzuara nuk zgjidhen me improvizime për një palë zgjedhje.

Ato zgjidhen me plane të mëdha, me punë të përditshme, me pjesëmarrje të qytetarëve në çdo hap.

Prandaj ne propozojmë një vizion të qartë: **Prishtina 2035.**

Një vizion dhjetëvjeçar, me matje e raportim të përvitshëm.

Një vizion që do ta bëjë Prishtinën qytet funksional, ekonomikisht të zhvilluar dhe shoqërisht të barabartë.

**Prishtina do të jetë
qyteti i mundësive,
jo i privilegjeve.**

Hajrulla Çeku



Prishtinë që funksionon, lagje që funksionon

Sot, lagjet e Prishtinës shpesh duken si grumbull ndërtesash të ndara. Papastërti, trotuare të zëna, rrugë të dëmtuara, mungesë ndriçimi. Shërbimet komunale janë të ngadalshme dhe shpesh qytetari ndihet i pafuqishëm.

Kjo nuk është e ardhmja e Prishtinës.

Prishtina 2035 do të funksionojë përmes lagjeve të saj.

Në katër vitet e para, do t'i fuqizojmë ndërmarrjet publike me menaxhim profesional dhe pa ndikime politike. Shërbimet do t'i zbresim në nivel të lagjes: pastrim, mbeturina, mirëmbajtje, ngrohje, ambulancë, parking, zjarrfikës e siguri komunitare. Vetë banorët, përmes këshillave të lagjes, do të monitorojnë shërbimet dhe investimet.

Transporti publik do të modernizohet me flotë të re autobusësh dhe linja sipas lëvizjes reale të qytetarëve. Lagjet periferike do të kenë planifikim urban dinjitoz, ndërsa të gjitha shërbimet – administratë, arsim, shëndetësi – do të digjitalizohen, që qytetari të mos ketë më nevojë të endet nëpër zyrat e komunës.

Në vitin 2035, Prishtina do të jetë qytet i jetueshëm. Lagjet do të jenë të pastra, të gjelbra, të sigurta. Fëmijët do të kenë hapësira lojërash, të moshuarit vende për rekreacion, familjet kopshtet e shkollat pranë. Trotuaret do të jenë të lira, rrugët të ndriçuara, trafiku i menaxhuar. Transporti publik do të lidhë çdo lagje e çdo fshat. Çdo shërbim komunal do të jetë digjital, i shpejtë dhe transparent.

Kryeqytet i zhvilluar ekonomi metropolitane

Sot, ekonomia e Prishtinës është e fragmentuar. Të rinjtë e industrisë kreative dhe TIK-ut nuk kanë hapësira. Shkollat profesionale janë të shkëputura nga tregu i punës. Bujqësia është e lënë pas dore. Turizmi është potencial i pashfrytëzuar.

Por Prishtina ka talent, ka energji dhe ka mundësi. Këto mundësi do t'i kthejmë në motor zhvillimi.

Në katër vitet e para, do të themelojmë Zonën Metropolitane të Prishtinës, duke e lidhur qytetin me Fushë Kosovën, Obiliqin, Podujevën, Lipjanin e Graçanicën. Vetëm bashkë, si ekonomi metropolitane, do të krijojmë fuqi punësimi e mirëqenie për të gjithë.

Do të mbështesim gratë dhe të rinjtë ndërmarrës me skema konkrete. Do të forcojmë industrinë kreative dhe TIK-un me hapësira krijuese, laboratorë dhe inkubatorë. Turizmi do të zhvillohet me festivale, ngjarje kulturore dhe sport të madh, me kulm Lojërat Mesdhetare 2030. Prodhuesit vendorë do të kenë tregje të hapura. Shkollat profesionale do të lidhen drejtpërdrejt me tregun e punës.

Në vitin 2035, Prishtina do të jetë epiqendra ekonomike e Kosovës. Papunësia do të jetë e papërfillshme. Bizneset do të rriten pa pengesa dhe do të jenë partnerë të komunës. Industria kreative, TIK-u dhe turizmi do të jenë shtyllat kryesore të punësimit. Gastronomia, kultura dhe jeta e natës do të tërheqin vizitorë nga rajoni dhe Evropa. Prishtina do të jetë qytet digjital dhe kryeqytet rajonal i kulturës dhe sportit.

Prishtina që garanton barazi askush nuk mbetet prapa

Një qytet nuk është i zhvilluar nëse një pjesë e tij mbetet pas.

Sot, qytetarët shpesh ndihen të përjashtuar nga vendimarrja.

Prokurimi publik shpesh është i errët, ndërsa interesat private marrin përparësi ndaj atyre publike. Skemat sociale nuk e fuqizojnë qytetarin, por shpesh e mbajnë në varësi.

Kjo duhet të ndryshojë.

Në katër vitet e para, ne do të ndërtojmë modelin e qeverisjes komunitare. Çdo vendim i komunës do të publikohet. Prokurimi publik do të hapet dhe monitorohet nga qytetarët. Banorët do të marrin pjesë në planifikim, në vendimarrje dhe në mbikëqyrje.

Skemat sociale do t'i reformojmë që qytetarët në nevojë të mos mbesin jashtë tregut të punës, por të bëhen pjesë aktive e tij. Qyteti do të projektohet e menaxhohet që të jetë i qasshëm për të gjithë, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara, për gratë, për të moshuarit.

Në vitin 2035, Prishtina do të jetë qytet i barabartë. Qeverisja do të jetë me duar të pastra, pa marrëveshje të fshehta. Çdo proces do të jetë transparent falë digjitalizimit. Pabarazitë sociale do të jenë zvogëluar. Fëmijët do të kenë arsim cilësor, art dhe sport. Qyteti do të jetë i hapur, gjithëpërfshirës, me dinjitet për secilin banor.

Ky vizion është angazhimi ynë

për ta kthyer Prishtinën te qytetari.

Pas fitores më 12 tetor, programi zgjedhor që e shoqëron këtë vizion do të jetë udhërrëfyes i përbashkët për të gjithë, udhëheqës e zyrtarë komunal, ekspertë e qytetarë, që së bashku të hartojmë programin qeverisës dhe të nisim pa humbur kohë zbatimin e qindra nismave dhe projekteve konkrete që do ta bëjnë Prishtinën funksionale, të zhvilluar dhe të të gjithëve.

Ky është vizioni ynë për Prishtinën 2035.

Qytet që funksionon. Kryeqytet i zhvilluar. Qytet i barazisë.

Nuk është premtim bosh, por plan i detajuar.

Brenda 100 ditëve të para do të shihen ndryshimet e para.

Brenda një viti do të ndihen rezultatet.

Brenda katër viteve do të shihet transformimi.

Sepse Prishtina nuk pret.

Sepse Prishtina meriton më shumë.

Sepse bashkë, ne do ta bëjmë realitet.



SEKTORËT PRIORITARË GJATË MANDATIT TË PARË TRAFIKU – PRISHTINA 2035

Prishtina sot është bllokuar.

Nuk është vetëm ndjenja jonë e përditshme nëpër kolona, është realiteti i një qyteti që nuk lëviz. Transporti publik nuk është alternativë e besueshme. Autobusët vonohen, nuk respektohet orari, e qytetarët nuk arrijnë me kohë aty kur kanë nevojë. Qytetarët detyrohen ta përdorin makinën edhe për lëvizjet më të vogla. Dhe kështu qyteti mbytet nga veturat.

Sistemi i semaforëve është i vjetëruar, punimet në rrugë pa plan e paralajmërim bllokojnë lagjet, ndërsa unaza e jashtme është vonuar së ndërtuari. Komuna nuk menaxhon trafikun, vetëm reagon, dhe vendime si mbyllja e sheshit Xhorxh Bush pa alternativa e kanë rënduar situatën.

Plani i Mobilitetit është harruar, parkingjet mungojnë, “Prishtina Parking” është politizuar, shtigjet e biçikletave janë të ndërprera. Trafiku mbetet ndotësi kryesor i ajrit dhe kërcënim për shëndetin, duke rritur edhe pabarazinë, sepse shumica që nuk vozisin, fëmijë, gra, të moshuar, persona me nevoja të veçanta, e gjejnë qytetin të ngushtë e të pasigurt.

Për çka angazhohemi ne?

Për një Prishtinë që funksionon, një kryeqytet të zhvilluar dhe një qytet të barabartë.

Trafiku në një Prishtinë që funksionon:

Trafiku është testi i parë i një qyteti që funksionon. Dhe ne do ta kthejmë funksionalitetin në çdo rrugë, në çdo lagje, në çdo shesh.

Brenda katër viteve të para do të ndërmarrim hapa të qartë:

- Model i kombinuar për funksionimin e sheshit Xhorxh Bush; një hapësirë publike e gjallë për këmbësorë, me dy korsi qarkullimi të kufizuar dhe mbyllje për trafik nga mbrëmja në mëngjes.
- Ekip i posaçëm për zbatimin e Planit të Mobilitetit, me të dhëna të përditësuara, rishikime të nevojshme dhe afate të qarta;
- Sistem SMART për menaxhimin e semaforëve dhe trafikut në kohë reale;
- Identifikim dhe hapje të fyteve të ngushta në segmentet më problematike të qytetit;
- Katër parkingje të mëdha “Parko & Udhëto” në hyrjet kryesore,

me çmim të ulët dhe lidhje të shpejtë me transport publik;

- Zëvendësimin me çmime progresive të parkimit, sipas përditësimit të Rregullores për Menaxhimin e Parkingjeve që buron nga Kuvendi Komunal;

- Amandamentimin e Rregullores për Menaxhim të Parkingjeve për ligjshmëri dhe qartësi të plotë, me menaxhim profesional.
Furnizimet në qendër do të bëhen vetëm në orare të caktuara.
Dhe rrjeti për biçikleta do të ketë vazhdimësi e siguri të plotë për lëvizje.

Në vitin 2035, Prishtina do të lëvizë lirshëm. Transporti publik modern do të jetë alternativë e parë, e shpejtë dhe e përbalueshme. Familjet prishtinase nuk do të kenë nevojë për disa makina. Lagjet do të kenë rrugë të sigurta, trotuare të lira, ndriçim të plotë. Ambulancat dhe zjarrfikësit do të arrijnë me shpejtësi dhe do të shpëtojnë jetë.

Trafiku në një Prishtinë të zhvilluar:

Një qytet nuk bëhet kryeqytet i zhvilluar nëse mbetet i ngujuar në trafik. Investimet tona strategjike në mobilitet janë investime në zhvillimin ekonomik të Prishtinës.

Parkingjet “Parko & Udhëto” në hyrjet kryesore do të ulin dukshëm fluksin e makinave në qytet, duke e liruar qendrën për lëvizje të lirshme. **Rrjeti i integruar metropolitan i transportit publik** do ta lidhë Prishtinën me Fushë Kosovën, Obiliqin, Podujevën, Lipjanin dhe Graçanicën. Kështu, edhe banorët e komunave fqinje do të kenë alternativë të shpejtë për të hyrë në Prishtinë pa makina.

Sheshi Xhorxh Bush do të kthehet në model të hapësirave urbane që kombinojnë qarkullimin e nevojshëm me jetën publike e kulturore. Si pasojë e relievit të qytetit, flotës aktuale të biçikletave do t’i shtohet rrjeti i biçikletave elektrike dhe transportit pa makina do ta kthejnë energjinë e qytetit te njerëzit. Dhe kështu, Prishtina do të bëhet jo vetëm qendër ekonomike, por edhe qendër e turizmit kulturor, sportit dhe jetës urbane.

Në vitin 2035, Prishtina do të jetë pjesë e hartës evropiane si qytet digjital dhe qytet i lëvizjes së lirë. Një qytet që tërheq

vizitorë me hapësira të hapura, ajër të pastër dhe infrastrukturë moderne.

Trafiku në një Prishtinë të barabartë:


Trafiku i sotëm i dëmton më së shumti ata që kanë më pak. Një qytet ku për të lëvizur lirshëm duhet patjetër të kesh makinë, është qytet që e rrit pabarazinë.

Ne do ta ndryshojmë këtë realitet.

Transporti publik i shpejtë dhe i përbalueshëm do t'i japë secilit qytetar lëvizshmëri të barabartë. Qendrat e qytetit do të hapen për këmbësorë, duke i kthyer hapësirat publike për njerëzit. Personat me aftësi të kufizuara do të kenë qasje të plotë në transport e rrugë. Qyteti do të jetë i sigurt për fëmijët, të moshuarit dhe çdo qytetar.

Në vitin 2035, Prishtina do të jetë qytet i barazisë. Ajri i pastër nuk do të jetë privilegj i disa lagjeve, por e drejtë për të gjithë. Lëvizja nuk do të jetë pengesë, por liri.





Prishtina përballlet me transport publik të keqmenaxhuar. “Trafiku Urban”, që nga 1974 duhej të ishte shtylla e lëvizjes, sot nuk e përmbush misionin. Flota prej 51 autobusësh të rinj të vitit 2018 nuk është zgjeruar, asnjë autobus elektrik nuk është blerë, ndërsa operatorët privatë përdorin mjete të vjetra e ndotëse pa monitorim.

Lagjet e reja nuk kanë linja të rishikuara, korsitë e dedikuara nuk shfrytëzohen dhe autobusët mbesin në kolona. Si rrjedhojë, transporti publik nuk është alternativë, por shembull i një qyteti që nuk funksionon.

Transporti publik në një Prishtinë që funksionon

Ne angazhohemi që në **katër vitet e para** ta kthejmë transportin publik në shërbim funksional, efikas dhe të besueshëm.

Do ta reformojmë dhe depolitizojmë plotësisht ndërmarrjen “Trafiku Urban” duke vendosur qeverisje të mirë korporative. Flota e autobusëve do të zgjerohet progresivisht, me prioritet për autobusë elektrikë. Linjat do të riorganizohen sipas zhvillimit të qytetit dhe nevojave aktuale të reja urbanistike. Stacionet do të jenë afër qytetarit, me qasje të sigurt për këdo, edhe për persona me aftësi ndryshe.

Do të ketë biletë të përballueshme për të gjithë në atë mënyrë që transporti publik të bëhet zgjedhja e parë.

Do të krijohen linja të veçanta, të shpejta e të shpeshta për në qendër, nga pikat kryesore si Fushë Kosova, Mati, Veterniku, Kodra e Trimave e Arbëria.

Në orët e pikut të trafikut, fluksi i nisjeve të autobusëve do të jetë më i shpeshtë se orari i zakonshëm.

Çdo fshat i Komunës së Prishtinës do të lidhet me rrjetin e transportit publik, deri në brendësi të fshatit.

Në qeverisjen tonë, gjatë mandatit të parë, operatorëve privatë do t’iu ofrojmë kontrata afatgjata, në mënyrë që ata ta kenë sigurinë e nevojshme për investime në përditësimin e flotës së autobusëve të tyre.

Do të ngriten pika të transferimit sipas idesë së Parko dhe Udhëto

në hyrje të qytetit dhe t'i transferojë brenda zonës qendrore. Korsitë e dedikuara për autobusë në korridoret kryesore do të jenë realitet.

Bileta dhe informacioni do të digjitalizohen, me tabela elektronike dhe orare të sakta në çdo stacion.

Qendra e Monitorimit të Transportit Publik do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien për qytetarët përmes aplikacioneve digjitale dhe do të ketë rritje të sigurisë dhe efikasitetit të shërbimit.

Këto janë masat që e kthejnë transportin publik në funksional.

Transporti publik në një Prishtinë të zhvilluar

Një kryeqytet nuk mund të zhvillohet nëse mbetet i ngujuar. Transporti publik është shtylla e parë e një ekonomie urbane moderne.

Në vitin 2035, Prishtina do të ketë rrjet modern transporti publik që lidhë në mënyrë efikase çdo lagje dhe çdo fshat me qendrën dhe me njëra-tjetrin.

Flota e autobusëve do të ketë mbi 200 mjete, shumica elektrike dhe ekologjike.

Parkingjet periferike "Parko & Udhëto" do ta lehtësojnë hyrjen në qytet për vizitorët, duke i nxitur ata të përdorin transportin publik. Kështu, transporti publik nuk do të jetë thjesht një shërbim i komunës, por do të jetë themel i zhvillimit të kryeqytetit.

Në vitin 2035, Prishtina do të jetë qendër e lëvizjes së qëndrueshme, pjesë e një sistemi të integruar metropolitan.

Transporti publik në një Prishtinë të barabartë

Transporti publik është barazi.


Një qytet ku mund të lëvizësh vetëm nëse ke makinë është qytet i padrejtë. Ne nuk e pranojmë këtë.

Me biletë të përballueshme, çdo qytetar do të ketë mundësi për lëvizje.

Në vitin 2035, Prishtina do të jetë qytet ku transporti publik nuk është opsion i fundit, por zgjedhja e parë.

Qytet ku lëvizja nuk është pengesë, por liri.

Qytet ku ajri është më i pastër, rrugët më të sigurta, dhe hapësirat publike i përkasin qytetarëve, jo makinave.



Menaxhimi i mbeturinave

Prishtina sot përballet me dështim të madh në menaxhimin e mbeturinave. Politizimi i ndërmarrjes “Pastrimi” dhe ndërhyrjet jo-ligjore të Kryetarit e kanë sjellë qytetin buzë kolapsit, duke lënë rrugë e lagje të tëra të mbuluara nga era e mbeturinave. Mungesa e transparencës ka bllokuar edhe projektet ndërkombëtare, ndërsa qytetarët nuk dinë as ku të paguajnë këtë shërbim. Financimi i ndërmarrjes është i paqëndrueshëm, kontenjerët mungojnë e, ata që janë, nuk mirëmbahen, mbeturinat mbliohen të përziera dhe përfundojnë në deponi. Riciklimi e kompostimi janë minimal, kamionët të vjetër e të paktë, deponitë mbushen e ndotin, shportat mungojnë dhe deponitë ilegale shtohen në çdo lagje e fshat.

Prishtina është kthyer në qytet që nuk pastrohet. Kjo do të ndryshojë.

Menaxhimi i mbeturinave në një Prishtinë që funksionon

Ne do ta bëjmë pastrimin funksional, të përditshëm, të besueshëm.

Gjatë katër viteve të para do të ndërmarrim masa konkrete:

- Reformë të plotë të ndërmarrjes “Pastrimi”, me menaxhim profesional e efikas;
- Digjitalizim i tërësishëm i sistemit të faturimit dhe pagesës;
- Së paku 1,500 kontenjerë të rinj në të gjitha lagjet dhe fshatrat, me bashkëfinancim të Komunës;
- Fillim i ndarjes së mbeturinave në burim: tri llojë të kontenjerëve për banesat kolektive (plastikë, letër, qelq) dhe dy për shtëpitë individuale (të përziera, qelq);
- Ndërtim i katër stacioneve të transferit në lagje të ndryshme për të reduktuar kohën e transportit dhe për të rritur efikasitetin;
- Investim në kamionë të rinj për mbledhje në lagje dhe transport në deponi.

Do të ndërtojmë Qendrën për trajtim të mbeturinave inerte e ndërtimore, që ato të riciklohen e të përdoren si material ndërtimor.

Do të ndërtojmë Qendrën për trajtim të mbeturinave voluminoze, me orar të rregullt për grumbullim nëpër lagje.

Do të hartojmë projektin e shndërrimit të mbeturinave të përziera në energji.

Do të krijojmë së paku 20 pika të veçanta për shishe e qelq, me mekanizëm të riciklimit.

Do të nisim ndarjen e mbeturinave në burim dhe kompostimin në amvisëri, me incentiva për qytetarët e bizneset.

Do të funksionalizojmë impiantin qendror të kompostimit për mbeturinat e gjelbra nga parqet dhe hapësirat publike, dhe do të zgjerojmë trajtimin e mbetjeve ushqimore në zonat urbane.

Do të mbyllim deponitë ilegale.

Do të publikojmë orarin e grumbullimit për secilën lagje dhe i njëjti nuk do t'jetë pengesë për qytetarët.

Prishtina do të bëhet shembull i menaxhimit të mbeturinave dhe do të promovojë projekte të përbashkëta rajonale zhvillimore, përtej grumbullimit.

Kështu funksionon një qytet që pastrohet çdo ditë.

Menaxhimi i mbeturinave në një Prishtinë të zhvilluar

Menaxhimi i mbeturinave nuk është vetëm higjienë. Është edhe zhvillim ekonomik.

Në vitin 2035, Prishtina do të ketë sistem modern të menaxhimit të mbeturinave dhe kontenjerë nëntokësorë.

Grumbullimi do të jetë i shpeshtë, transporti i shpejtë, trajtimi i avancuar.

Mbeturinat inerte dhe voluminoze do të riciklohen. Pajisjet elektronike do të trajtohen në mënyrë të sigurt.

Ekonomia qarkore dhe riciklimi do të ulin vëllimin e deponive, duke krijuar kështu vende të reja pune në ekonominë e gjelbër.

Qendra e trajtimit të mbeturinave ndërtimore do të prodhojë material të ripërdorshëm.

Riciklimi i mbeturinave voluminoze do të krijojë hapësirë për krijimin e biznese të reja të kësaj fushe.

Ky nuk është vetëm pastrim, kjo është ekonomi.

Në vitin 2035, Prishtina do të jetë model i zhvillimit të qëndrueshëm. Një kryeqytet i pastër dhe i gjelbër.

Menaxhimi i mbeturinave në një Prishtinë të barabartë

Mbeturinat nuk i bëjnë dëm vetëm imazhit të qytetit. Ato dëmtojnë më së shumti ata që kanë më pak mundësi: lagjet e varfra, fshatrat, periferitë.

Deponitë ilegale janë më të shpeshta atje ku banorët nuk kanë zë të fuqishëm. Mungesa e kontenierëve është më e dukshme në lagjet më të lëna pas dore. Dhe kështu, papastërtia bëhet formë e pabarazisë.

Ne do ta ndryshojmë këtë realitet.

Kontenjerë të rinj në çdo lagje e fshat. Orar i qartë për grumbullim në çdo rrugë. Shërbim i barabartë për secilin qytetar. Incentiva për amvisëritë që ndajnë e riciklojnë. Shporta për mbeturina në çdo rrugë. Qytet i pastër për secilin, jo vetëm për disa.

Në vitin 2035, Prishtina do të jetë qytet i barazisë edhe në pastërti.

Deponitë ilegale do të jenë zhdukur.

Qytetarët do të jetojnë në mjedis të shëndetshëm, të pastër, të barabartë.





Bizneset, TIK dhe industria kreative

Prishtina ka talent, ide dhe shpirt ndërmarrësie, por mungon vizion e qasje e integruar për zhvillim ekonomik. Të rinjtë me aftësi krijuese e TIK punojnë të izoluar, pa hapësira të përbashkëta për bashkëpunim, çka kufizon inovacionin. Kryeqyteti nuk e shfrytëzon praninë e Universiteteve për aplikim të dijes, ndërsa bizneset e mëdha nuk kanë zonë të dedikuar me infrastrukturë. Startupet dhe bizneset e vogla, veçanërisht të rinjve e grave, nuk mbështeten mjaftueshëm. Shërbimet komunale të dobëta e rëndojnë ambientin e biznesit. Nuk ka bashkëpunim me komunat fqinje, edhe pse ekonomia lokale lidhet ngushtë me to. Si rezultat, qytetarët nuk gëzojnë kushte të përshtatshme për biznes e rritje të të hyrave familjare.

Prishtina ka potencial të madh për zhvillim ekonomik, por ky potencial duhet të kthehet në realitet.

Gjatë katër viteve të para, ne do të ndërmarrim një sërë veprimesh dhe projektesh kryesore që do ta rrisin zhvillimin ekonomik lokal dhe do ta kthejnë kryeqytetin në epiqendër të inovacionit dhe prodhimit.

Do të krijojmë platformën politike dhe sekretariatit teknik për **Zonën Metropolitane të Prishtinës**, në bashkëpunim me komunat e Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Graçanicës dhe Podujevës, duke integruar zhvillimin ekonomik në të gjithë rajonin. Në Bërnice do të themelojmë **Parkun Industrial** me sipërfaqe prej 116 hektarësh, të pajisur me infrastrukturë moderne dhe lehtësira logjistike e teknike për prodhuesit vendorë, që do të operojnë nën brendin "Made in Prishtina".

Një program i granteve do t'u ofrohet grave, vajzave dhe djemve sipërmarrës të Prishtinës, duke nxitur ndërmarrësinë e re dhe punësimin e qëndrueshëm. Për industrinë e TIK-ut, do ta krijojmë **Kullën e TIK (ICT Tower)** në Prishtinë, si qendër nxitëse të sektorit, dhe do të shfrytëzojmë **Parkun Teknologjik në Bërnice**, i cili do të shoqërohet me qendra satelite në lagje të ndryshme të qytetit, me hapësira të përbashkëta dhe të përbalueshme pune (co-working space) dhe inkubatorë teknologjik.

Krahas kësaj, do të themelojmë **Qendrën Kreative të Prishtinës**, e cila do të përfshijë laboratorë për prodhim digjital (FabLab), qendra të krijimit aplikativ (MakerSpace) dhe inkubatorë kreativ. Njësia e dedikuar komunale për koordinim strategjik të Prishtinës kreative do të punojë për të forcuar këtë ekosistem, ndërsa integrimi i **Zonave të Bizneseve Kreative** në hapësirat urbane të përziera do të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet profesionistëve dhe inovacionin, duke i dhënë jetë të re zonave të qytetit.

Zhvillimi do të mbështetet edhe përmes **bashkëpunimit strategjik me Universitetin e Prishtinës, universitetet private, shkollat profesionale dhe bizneset**, për nxitjen e hulumtimit dhe zhvillimit (Research & Development), inovacionit dhe lidhjes së shkollimit me tregun e punës. Në hapësirat publike do të ofrohet internet falas, ndërsa internet i shpejtë do të sigurohet në të gjitha zonat teknologjike e kreative.

Do të zbatojmë **programe grantesh për startupe kreative, aplikacione kulturore digjitale dhe art publik**, me theks të veçantë për bizneset e udhëhequra nga gratë dhe të rinjtë. Krahas tyre, do të zhvillohen **programe trajnimi për shkathtësi kreative**, dizajn, kodim, video-editim, UI/UX, marketing digjital, dhe audio, në partneritet me biznese vendore dhe ndërkombëtare. Një **platformë bashkëpunimi ndër-industrial** do të krijohet për të shfrytëzuar kapacitetet kreative në zeje e industri tradicionale si druri, bujqësia apo tekstili.

Turizmi dhe kultura do të përfitojnë nga planifikimi strategjik dhe incentivat për rritje të kapaciteteve akomoduese, përfshirë **rifunksionalizimin e objektit të Hotel Grand** në qendër të qytetit. Do të krijohen **mini-zona tematike artizanale**, si p.sh. “Rruga e Argjendarëve”, me investim në infrastrukturë dhe brendim për të nxitur biznesin dhe turizmin.

Jeta e natës do të planifikohet përmes përcaktimit të zonave të veçanta me paketa të integruara për leje pune dhe menaxhim të ndotjes akustike.

Ndërkohë, një **skemë bashkë-financimi** do të ndihmojë bizneset të marrin pjesë në panaire ndërkombëtare dhe programe shkëmbimi ekonomik.

Prishtina e vitit 2035 do të jetë një **ekonomi metropolitane** e lidhur ngushtë me komunat fqinje dhe e hapur ndaj trendeve globale të zhvillimit. Qyteti do të ketë një ekosistem funksional e të integruar të dijes, inovacionit dhe ndërmarrësisë, falë bashkëpunimit të ngushtë të Komunës me bizneset, sipërmarrësit, universitetet, shkollat profesionale, qeverinë qendrore dhe donatorët ndërkombëtarë.

Rrjeti i hapësirave krijuese do të ofrojë ambiente të përballueshme për punë dhe bashkëpunim, duke nxitur inovacionin dhe lehtësuar punën e të rinjve e të rejave. Sektori i TIK-ut do të jetë i njohur ndërkombëtarisht dhe do ta ketë ndihmuar Prishtinën të shndërrohet në një qytet SMART.

Bizneset e mëdha do të operojnë me lehtësi në **Parkun Industrial të Bërnices**, me infrastrukturë moderne dhe mbështetje të plotë, ndërsa numri i lartë i bizneseve të vogla, sidomos të udhëhequra nga gratë dhe të rinjtë, do të krijojë punësim të qëndrueshëm. Zhvillimi ekonomik do të reflektojë në të gjitha lagjet dhe fshatrat e qytetit, duke sjellë mirëqenie të shpërndarë dhe mundësi për të gjithë.



ZHVILLIMI RURAL

Fshatrat e Prishtinës kanë potencial të madh bujqësor, por prodhimi është i vogël, i fragmentuar dhe pa qasje të sigurt në treg. Fermerët me prona të vogla mbesin pa mbështetje, mungon zinxhiri “fermë-përpunim-shitje” dhe tregjet në qytet janë të pamjaftueshme për produktet vendore.

Potenciali për agro-turizëm e turizëm malor mbetet i pashfrytëzuar, ndërsa mungesa e ujësjellësit publik në 22 fshatra dhe transportit të rregullt publik e ndrydhë më tej zhvillimin e zonave rurale.

Por ne e dimë: **pa fshatra të gjallë, nuk ka kryeqytet të zhvilluar.**

Prishtina që funksionon – edhe në fshat

Gjatë katër viteve të para do të bëjmë funksional çdo fshat të Prishtinës.

– Investimet infrastrukturore do të kenë prioritet në fshatra, me fokus në lidhjen me ujësjellës dhe transport publik të rregullt, deri në brendësi;

– Ndërtimi i tregjeve të reja mobile në secilën lagje të Prishtinës, me orar të rregullt, ku fermerët e fshatrave do të kenë prioritet;

– Do ta fuqizojmë ndërmarrjen publike **Kuzhina Qendrore**, duke e krijuar rrjetin e menzave të përballueshme, me furnizim prioritar nga fermerët e Komunës së Prishtinës.

Kështu, edhe fshati bëhet pjesë e qytetit që funksionon.

Prishtinë e zhvilluar – me ekonomi rurale të fortë

Zhvillimi ekonomik lokal nuk kufizohet në qendër të qytetit. Ai fillon në fshat.

Gjatë katër viteve të para, do të krijojmë skema komunale të përshtatura për grante të vogla për fermerë, me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës, higjienës, cilësisë së produkteve dhe plasimit të tyre në treg, duke e përmirësuar të gjithë zinxhirin: **prodhim – përpunim – shitje**;

– Prioritet është zhvillimi i programit “**10 fshatrat**”, për fshatrat me potencial për agroturizëm, me investime të integruara në infrastrukturë, shtigje dhe sinjalistikë, kalendar ngjarjesh dhe

mbështetje të aktiviteteve ekonomike;

- Ofrimi i ndihmës teknike dhe ndërlidhje me industrinë kreative, për dizajn, paketim, marketing dhe certifikim me gjeo-tregues lokal;

- Gastronomia e qytetit do të lidhet ngushtë me prodhimin e fshatrave, duke sjellë autenticitet e shije vendore në çdo tryezë të Prishtinës.

Kështu, fshati bëhet pjesë e kryeqytetit të zhvilluar.

Zhvillimi rural në një Prishtinë të barabartë

Barazia nuk është vetëm në shërbime urbane. Barazia është që edhe banorët e fshatrave të kenë qasje të barabartë në shërbime, tregje e mundësi zhvillimi.

- Fermerët do të kenë mbështetje të vazhdueshme;

- Familjet në fshat do të kenë mundësi të jetojnë me dinjitet nga puna e tyre;

- Të rinjtë e fshatrave do të gjejnë punësim në bujqësi, turizëm rural e agroturizëm, pa qenë të detyruar të migrojnë drejt qendrës ose jashtë vendit.

15

Kështu, fshati bëhet pjesë e qytetit të barazisë.

Fshatrat e Prishtinës në vitin 2035

Në vitin 2035, fshatrat e Prishtinës janë të gjallëruara dhe me ekonomi familjare të zhvilluara.


Fermerët prodhojnë produkte cilësore e autentike, të përpunuara me vlerë të shtuar, dhe i shesin në tregjet e shumta të qytetit.

Gastronomia urbane furnizohet nga prodhuesit vendorë, përfshirë Kuzhinën Qendrore.

Agroturizmi dhe turizmi malor ofrojnë mundësi atraktive për vizitorë vendorë dhe të huaj, duke sjellë të ardhura shtesë dhe punësim për të rinjtë.

Çdo fshat është i lidhur me ujësjellës publik dhe me transport publik të rregullt.

Fshatrat e Prishtinës kanë prosperitet dhe imazh pozitiv për vizitorët.



TURIZMI

Prishtina sot

ka potencial të jashtëzakonshëm për t'u shndërruar në destinacion turistik të njohur, por ky potencial ende nuk është shfrytëzuar. Ne e dimë se turizmi nuk është vetëm argëtim: ai është zhvillim ekonomik, imazh ndërkombëtar dhe mundësi për punësim të të rinjve. Prandaj, **në katër vitet e para**, ne do të ndërmarrim masa të qarta e të matshme për ta bërë turizmin prioritet zhvillimor të Prishtinës.

Turizmi në një Prishtinë që funksionon

Një qytet nuk mund të jetë destinacion turistik nëse nuk funksionon për banorët dhe vizitorët.

- Turizmi do të shpallet një nga prioritetet zhvillimore të kryeqytetit, me shtim të investimeve publike e private në infrastrukturë dhe kapacitete turistike, kulturore e sportive;
- Do të identifikojmë **10 atraksionet kryesore të qytetit**, me plane investimi dhe mirëmbajtjeje, duke i kthyer ato në shembull të shpejtë të transformimit;
- Do të hapim **Qendrën për Vizitorë** në qendër të qytetit, me orar të zgjatur, informacione të plota e aplikacion digjital shumëgjuhësh;
- Do të mbështesim e stimulojmë **guidat lokale**, duke i trajnuar e promovuar, ndërsa guidat e huaja do të inspektohen për standarde profesionale.

83

Një Prishtinë e zhvilluar me ekonomi turistike të qëndrueshme

Turizmi është motor zhvillimi ekonomik. Ne do ta vendosim atë në zemër të transformimit të kryeqytetit. Prandaj ne prioritojmë:

- Brandimin e Prishtinës dhe promovimin profesional në tregjet ndërkombëtare;
- Përkrahjen strategjike të festivalit **Sunny Hill**, si dhe festivalet e tjera kulturore, sportive dhe gastronomike gjatë gjithë vitit;
- **Hartimin e Kalendarit Vjetor të Aktiviteteve**, në koordinim me hotelet, operatorët turistikë dhe festivalet;
- Mbështetjen e gastronomisë autentike dhe jetën e natës, për

diversifikim të ofertës turistike, me standarde të larta sigurie;
 - Zhvillimin e programit **“Shtëpia e Miqve”**, për ekonomitë familjare në qytet dhe fshatra, me mikro-grante për renovim, standardizim të shërbimeve dhe përfshirje në platformat globale të rezervimeve;

- Zbatimin e **taksës turistike prej 0.5 euro për natë** për turistët e huaj, me destinim të qartë të mjeteve për zhvillim turistik, në konsultim me komunitetin;

- Hartimin e qasjes strategjike në investimet për **Lojërat Mesdhetare 2030**, duke e shfrytëzuar infrastrukturën sportive e kulturore për përdorim afatgjatë dhe shumëfunksional.

Kështu, turizmi bëhet burim i qëndrueshëm të ardhurash dhe Prishtina kthehet në kryeqytet të zhvilluar e tërheqës.

Turizmi në një Prishtinë të barabartë

Turizmi nuk është vetëm për vizitorët. Ai është për komunitetin. Ne do ta ndërtojmë një model turistik që përfiton çdo banor i Prishtinës.

- Programi **“Shtëpia e Miqve”** do të ofrojë mundësi të reja për familjet, sidomos ato me të ardhura më të ulëta, duke krijuar ekonomi të vogla familjare në turizëm;
- Komuniteti do të ketë fjalën e tij në përdorimin e të hyrave nga taksa turistike;
- Shumëngjyreshmëria kulturore e qytetit do të shndërrohet në përparësi: çdo lagje, çdo fshat dhe çdo komunitet do të ketë hapësirë të barabartë për ta prezantuar identitetin e tij.

Turizmi i Prishtinës do të jetë gjithëpërfshirës dhe do t’i shërbejë barazisë sociale.

Turizmi në Prishtinën e vitit 2035

Në vitin 2035, Prishtina është një destinacion turistik i veçantë dhe i njohur ndërkombëtarisht.

Qyteti ka identitet dhe brand të qartë turistik.

Atraksionet kryesore janë të pastra, të mirëmbajtura dhe të qasshme.

Informacioni është digjital, i shumëgjuhshëm dhe i menaxhuar nga guida vendore profesionale.

Prishtina ka jetë nate të sigurt e dinamike, gastronomi autentike dhe turizëm rural të integruar.

Agroturizmi në fshatra ofron përvoja të veçanta, ushqim lokal dhe aktivitete malore, duke sjellë të ardhura shtesë për banorët. Organizimi i Lojërave Mesdhetare 2030 ka transformuar kapacitetet akomoduese e organizative, duke i dhënë Prishtinës mundësinë të jetë nikoqire e shumë ngjarjeve ndërkombëtare.

Komuna, bizneset dhe komuniteti kanë krijuar një ekosistem turistik të **qëndrueshëm**, që gjeneron vende pune, të ardhura dhe një imazh të ri, pozitiv, për Prishtinën.



SIGURIA PUBLIKE

Prishtina është komuna me numrin më të madh të veprave penale në Kosovë, me rreth 38% të totalit në vitin 2024. Planifikimi hapësinor nuk e merr parasysh perceptimin e sigurisë, ndaj qytetarët ndihen të pasigurt në lagje, parqe e hapësira publike, sidomos gratë dhe fëmijët, për shkak të mungesës së ndriçimit dhe qenve endacakë. Numri i aksidenteve rrugore mbetet i lartë, ndërsa mbi gjysmën e qytetit nuk ka trotuare funksionale, duke e bërë lëvizjen e këmbësorëve të pasigurt, sidomos për fëmijë, gra e të moshuar.

Në vitin 2024, rreth 34% e rasteve të dhunës në familje në Kosovë u raportuan në Prishtinë. Mekanizmat e parandalimit dhe mbështetjes për viktimat nuk funksionojnë plotësisht, strehimoret kanë probleme financimi, ndërsa dhuna në shkolla vazhdon. Shumë hapësira të ndjeshme mbesin pa kamera. Siguria në qytet duhet të rritet.

Siguria publike në një Prishtinë që funksionon

Siguria e qytetarëve fillon nga gjërat e përditshme:

- Ndriçimi i plotë i të gjitha rrugëve kryesore, zonave pranë shkollave, kopshteve dhe parqeve;
- Zgjerimi i ndriçimit publik edhe në rrugë dytësore, lagje periferike e fshatra;
- Kompletimi i sistemit të **kamerave publike**, në përputhje me ligjin, përfshirë njohjen e targave të makinave dhe **Qendrën Komunale të Monitorimit**, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës;
- Investimi në **infrastrukturë mbrojtëse** pranë shkollave e kopshteve: trotuare, kënde lojërash, sinjalizim rrugor;
- Shtimi i patrullimeve policore në zonat e ndjeshme dhe ato periferike.

Prishtina që funksionon është qytet ku ndihesh i mbrojtur ditë e natë, në lagje apo në qendër.

Siguria publike në një Prishtinë të zhvilluar

Një kryeqytet nuk mund të pretendojë zhvillim pa siguri të qëndrueshme.

Ne prioritizojmë:

- Ndërtimi i një sistemi sigurie të bazuar në teknologji: kamera moderne, qendra monitorimi dhe menaxhim i integruar i të dhënave, gjithnjë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Menaxhimi i popullsisë së qenve endacakë me qasje humane e efektive: sterilizim, vaksinim, strehimore komunale, programe monitorimi;
- Fuqizimi i **Këshillave Lokale për Siguri në Bashkësi**, me trajnime, projekte konkrete dhe rritje të pjesëmarrjes së banorëve;
- Thellimi i bashkëpunimit mes Komunës dhe Policisë, duke sjellë patrullim të rritur, veçanërisht në zonat periferike dhe rurale.

Një kryeqytet i zhvilluar është kryeqytet ku teknologjia dhe komuniteti bashkëpunojnë për siguri më të lartë.

88

Siguria publike dhe mirëqenia sociale në një qytet të barabartë

Siguria nuk është vetëm çështje infrastrukture; ajo është çështje dinjiteti e barazie. Prandaj planifikojmë:

- Investimin në kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore të **Qendrës për Punë Sociale**;
- Fuqizimin e mekanizmave komunalë për parandalimin e dhunës në familje;
- Sigurim të **financimit të qëndrueshëm për strehimoret e viktimave të dhunës**;
- Mbështetjen e programeve të vetëdijesimit në shkolla dhe komunitet për parandalimin e dhunës dhe për sigurinë publike;
- Zbatimin në mënyrë të rreptë të **Protokollit për parandalimin e dhunës në shkolla**, për të identifikuar herët bullizmin dhe dhunën.

Një qytet i barabartë është ai ku gratë, fëmijët, të moshuarit dhe të gjithë qytetarët ndihen të lirë e të mbrojtur, pa frikë e pa dhunë.

Siguria publike në Prishtinën e vitit 2035

Në vitin 2035, Prishtina është qytet i sigurt.

Ndriçimi mbulon çdo rrugë, çdo lagje e çdo fshat.

Kamerat moderne dhe qendrat e monitorimit sigurojnë mbikëqyrje të shpejtë e efikase dhe privatësi për qytetarët;


Trotuaret dhe hapësirat publike janë të mbrojtura e miqësore për fëmijët;

Dhuna në familje është ulur ndjeshëm, viktimat mbështeten, e bullizmi në shkolla trajtohet me mekanizma adekuatë;

Popullsia e qenve endacakë është menaxhuar me masa humane;

Këshillat e Sigurisë në Bashkësi funksionojnë kudo, dhe bashkëpunimi me Policinë e Kosovës është i përditshëm e efektiv.

Qytetarët ndihen të lirë, të mbrojtur, të barabartë.



HAPËSIRAT PUBLIKE

Prishtina ka shumë pak hapësira publike, vetëm 30% të zonës urbane, larg standardit evropian prej 45%. Trotuaret janë të pamjaftueshëm, shpesh pa vazhdimësi, të uzurpuar nga parkimet dhe të papërshtatshëm për persona me aftësi ndryshe apo prindër me karroca. Shumica e lagjeve nuk kanë parqe, kënde lojërash apo hapësira për aktivitete, ndërsa inspektimet ndërtimore nuk sigurojnë respektimin e obligimeve për hapësira të përbashkëta. Përveç Gërmisë, hapësirat ekzistuese janë të koncentruara në qendër dhe në fshatra mbesin të papërcaktuara, shpesh të pasigurta, pa ndriçim e pa mirëmbajtje. Menaxhimi është i shpërndarë, pa strategji e koordinim, dhe pronat komunale keq-menaxhohen, shpesh jepen jo-transparente dhe pa i shërbyer interesit publik. Prishtina është qyteti ynë i përbashkët, por sot hapësirat publike nuk i përkasin të gjithëve.

Hapësirat publike në një Prishtinë që funksionon

Në katër vitet e para do të ndërmarrim hapa të qartë:

- Auditimi i **hapësirave publike dhe pronave komunale** në secilën lagje e fshat dhe hartimi i një **Plan për zhvillim e menaxhim të integruar**, që në 100 ditëshin e parë të qeverisjes;
- Hartimi i një **Strategjie të integruar për hapësirat publike**, si derivat i PZHK, për të arritur standardin 45%;
- Lirimi i trotuareve dhe hapësirave publike të uzurpuara, me **inspektim të rregullt dhe masa të qarta ndaj uzurpatorëve**;
- Krijimi i një **ndërmarrjeje të re komunale për mirëmbajtje të hapësirave publike**, me ndriçim, siguri dhe qasje universale për të gjithë;
- Vendosja e një **mekanizmi për raportim qytetar** të dëmtimeve dhe pengesave, përmes platformës “e-Prishtina”;
- Prioritizim i rregullimit dhe mirëmbajtjes së varrezave të qytetit përmes rritjes së efikasitetit të punës dhe investimeve në ndërmarrjen ‘Gjelbër’.

Prishtina që funksionon është qytet ku hapësirat publike janë të pastra, të mirëmbajtura dhe të lira nga abuzimet.

Hapësirat publike në një Prishtinë të zhvilluar

Hapësirat publike janë pjesë e zhvillimit të kryeqytetit dhe do të investojmë në to me vizion të qartë:

- Ndërtimi çdo vit i **të paktën 5 parqeve të vogla e të mesme dhe 5 hapësirave të reja publike** në lagje e fshatra, me bashkëfinancim nga Komuna dhe bizneset;
- Revitalizimi **dhe krijimi i brezit kulturor** nga Tulltorja deri në qendër të qytetit, te Pallati i Rinisë, duke kthyer hapësirat e braktisura në qendra të reja të jetës kulturore;
- **Kërkesa të qarta e obligative për hapësira publike** në çdo leje ndërtimore dhe fuqizimi i inspektimit për zbatimin e tyre;
- **Invetarizimi dhe publikimi i të gjitha pronave komunale**, për menaxhim transparent;
- Planifikimi bashkë me komunitetin për përdorimin e pronave komunale për **zhvillim kulturor, sportiv dhe ekonomik**, duke u dhënë përparësi grave dhe të rinjve.

Një kryeqytet i zhvilluar është ai që ka hapësira publike dinamike, ku zhvillohet jeta kulturore, ku mbështetet ekonomia vendore dhe ku përqafohen inovacioni dhe komuniteti.

Hapësirat publike në një Prishtinë të barabartë

Hapësira publike nuk është luks, por e drejtë e barabartë e çdo qytetari. Ne i prioritojmë:

- Rregullimin e pronësisë dhe menaxhimin e hapësirave të përbashkëta në ndërtesa kolektive, me modele bashkë-menaxhimi me banorët dhe ndërmarrjet publike;
- Sigurimi i **hapësirave që të mos uzurpohen**.

Një qytet i barabartë është ai ku hapësira publike nuk është privilegj i disave, por e drejtë e të gjithëve.

Hapësirat publike në Prishtinën e vitit 2035

Në vitin 2035, Prishtina ka arritur standardin prej **45% hapësirë publike**.

Çdo lagje dhe çdo fshat ka parqe, kënde lojërash dhe hapësira komunitare.

Trotuaret janë të lira për këmbësorë, pa pengesa e pa uzurpime. Hapësirat publike janë të planifikuara bashkë me komunitetin dhe shfrytëzohen për **interesa sociale, kulturore, ekonomike e ambientale**.

Prishtina është qytet i gjelbër, i gjallë dhe i hapur.

Ky është zotimi ynë: të kthejmë hapësirat publike qytetarëve dhe ta bëjmë Prishtinën qytet të përbashkët, qytet të lirë, qytet të barabartë.



Shërbimet në lagje

Prishtina është kthyer në grumbull ndërtesash e rrugësh të izoluar, pa jetë komunitare e shërbime bazike. Lagjet vuajnë nga mungesa e kopshteve, shkollat e mbingarkuara, shërbimet shëndetësore të pamjaftueshme, rrugë të dëmtuara pa ndriçim, pa trotuare e parqe, transport publik i rrallë dhe mbeturina të pranishme. Investimet bëhen pa konsultim e mungesa e mirëmbajtjes i degradon. Ankesat humbin në burokraci, banorët jetojnë të shkëputur. Nuk ka jetë komunitare. Lagjeve duhet t'u kthehet shpirti dhe funksioni bazë.

Lagjet në një Prishtinë që funksionon

Brenda **katër viteve të para, ne do të:**

- Identifikojmë nevojat dhe mangësitë e secilës lagje dhe fshat, duke përfshirë banorët përmes **Kartelës së Lagjes/ Fshatit** me 20 indikatorë të shërbimeve themelore;
- Planifikojmë **investime prioritare** për secilën lagje, të vendosura bashkë me banorët, sipas ndikimit pozitiv në jetën e përditshme;
- Zbresim shërbimet komunale në nivel të lagjes me konceptin **"Ndërmarrja e Lagjes"**, si pikë primare për aplikimet e banorëve procedura administrative, ankesa apo kërkesa, në formë fizike dhe digjitale. E njëjta qasje do të aplikohet për grupet e fshatrave në afërsi;
- Ndërtojmë ose përmirësojmë rrjetin e **ujësjellësit, kanalizimit dhe ujërave atmosferike**, si dhe do të zgjerojmë shtrirjen e **ngrohjes me Termokos**;
- Investojmë në **ndriçim publik, kontenierë e shporta për mbeturina, pika emergjence dhe infrastrukturë sigurie** në çdo lagje;
- Risim numrin e pikave të **Njësisë së Zjarrfikësve** për reagim të shpejtë në secilën lagje.

Një qytet që funksionon është ai ku çdo lagje ka shërbime bazike të sigurt dhe të qasshme.

Lagjet në një Prishtinë të zhvilluar

Lagjet nuk duhet të jenë vetëm vendbanime, por qendra të jetës qytetare. Ne do të:

- Ndërtojmë dhe revitalizojmë **hapësira të përbashkëta** – oborre, kënde të hapura, qendra multifunksionale – që do të shndërrohen në qendra komunitare për banorë;
- Garantojmë që secila lagje të ketë: **parkun e vet, këndin për fëmijë, fushën sportive, amfiteatrin e hapur dhe qendrën komunitare** për të moshuar, të rinj e aktivitete kulturore;
- Organizojmë **tregun e lagjes**, në secilën lagje, me produkte nga fermerët e rajonit të Prishtinës, duke e lidhur drejtpërdrejt bujqësinë lokale me qytetin;
- Mbështesim **objektet kolektive** me mirëmbajtje, ashensorë dhe hapësira të përbashkëta, duke krijuar **Këshillat e Banorëve** për menaxhim të përbashkët;
- Zbatojmë një **program të posaçëm për lagjet periferike**, me fokus të kopshtet publike, shkollat, transporti publik dhe qendrat shëndetësore;

Një kryeqytet i zhvilluar është ai që i shndërron lagjet në qendra të gjalla ekonomike, kulturore e sportive.

Lagjet në një Prishtinë të barabartë

Lagjet nuk duhet të jenë thjesht hapësira fizike, por komunitete aktive ku banorët kanë zë dhe fuqi vendimmarrëse.

- Banorët do të përfshihen drejtpërdrejt në **planifikimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve komunale**, përmes **Këshillave të Lagjeve**;
- Do të krijojmë një **sistem të integruar për trajtimin e shpejtë të kërkesave të banorëve**, për çdo shërbim komunal;
- Do të zhvillojmë modele të **bashkë-menaxhimit** për hapësirat e përbashkëta, duke i kthyer banorët në pronarë të vërtetë të lagjes së tyre.

Një qytet i barabartë është ai ku çdo banor, në çdo lagje, ndjen se ka zë dhe kontroll mbi hapësirat e veta të përbashkëta.

Prishtina 2035 – qytet i lagjeve funksionale

Në vitin 2035, lagjet e Prishtinës janë funksionale dhe të gjalla.

Çdo banor ka shërbime bazike brenda distancës së ecjes:

kopshte e shkolla, qendra shëndetësore, treg i lagjes, transport publik i besueshëm, parqe e hapësira komunitare.

Oborret dhe amfiteatrot e hapur janë shndërruar në qendra të jetës komunitare, ku zhvillohen aktivitete kulturore, rinore e sociale.

Banorët nuk e shohin më lagjen si vend të huaj, por si komunitet aktiv që ofron siguri, gjallëri dhe jetë të dinjitetshme.

Këshillat e Lagjeve janë ura të forta komunikimi me Komunën, duke garantuar reagim të shpejtë dhe shërbime të integruara.

Prishtina është kthyer në një qytet të lagjeve me shpirt komunitar

– një qytet të jetueshëm për secilin banor, në çdo cep.



SEKTORËT E TJERË

PRISHTINA 2035

Administrata dhe Qeverisja

Gjendja sot:

Administratë e pa-udhëhequr dhe e politizuar; pak shërbime digjitale; procedura të paqarta; pritje të gjata; koordinim i dobët mes drejtorive; vendimmarrje kaotike me Kuvendin Komunal; rekord vendimesh joligjore dhe gjetje të rënda nga auditori; mungesë planifikimi financiar dhe përdorim eksperimental i buxhetit; profesionistë të përjashtuar; mungesë mbledhjeje/analize të të dhënave.

4 vitet e para:

- “e-Prishtina”: digjitalizim i plotë nga aplikimi të dokumenti final; rritje e numrit të e-kiosqeve;
- Investime në TIK, sisteme të brendshme për gjurmim detyrash/ vendimesh dhe status online për çdo aplikim;
- Rritje e numrit të bashkësive lokale; takime të rregullta e të dokumentuara Kryetar – drejtorë – Kuvend Komunal;
- Rekrutim/avancim meritë; depolitizim; matje performance dhe feedback nga qytetarët.

Vizioni 2035: Administratë profesionale, transparente, e gjurmueshme; të gjitha shërbimet online; vendimmarrje mbi të dhëna; bashkëpunim funksional me Kuvendin Komunal; ligjshmëri standard; karrierë mbi meritë.



Planifikimi Hapësinor

Gjendja sot:

Oytet pa plan; PZHK me të dhëna 2011 dhe miratuar në 2013, pa konsultim; mungesë hartash zonale/plane rregulluese (shumë të vjetra); kadastra e pambaruar; >80,000 objekte pa leje; legalizim joefikas e jotransparent.

4 vitet e para:

- Rifillimi i PZHK-së si dokument vizionar me përfundim brenda vitit të parë, me Bord Koordinues, grupe profesionale, konsultime të gjera dhe monitorim vjetor;
- Krijimi i Hartës Zonale dhe Planeve Rregulluese në përputhje me PZHK-në (1 vit pas aprovimit të PZHK-së);
- “Rindërtim kadastral” në zona prioritare në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe donatorëve;
- Investime të vogla e të shpejta në lagje dhe fshatra;
- Hartimi i planit të projekteve madhore strategjike;
- Digjitalizimi i lejeve dhe pilotimi i legalizimit proaktiv të pronave;
- Trajtimi prioritar i ndërtimeve pa leje në pronën publike, korridoret infrastrukturore, tokat bujqësore dhe në zonat e mbrojtura.

Vizioni 2035:

Zhvillim mbi plan afatgjatë; lagje të integruara me shkolla/kopshte/parqe/infrastrukturë; legalizim i zgjidhur; kadastra e harmonizuar; procese të plota digjitale dhe transparente.



Gjendja sot:

Ajër i ndotur (trafik, ngrohje me dru/qymyr, izolim i dobët), rrjet ngrohjeje i pamjaftueshëm e i shtrenjtë; betonizim, pak gjelbërim; menaxhim i dobët i mbeturinave dhe ujërave të zeza; rrezik nga fatkeqësitë; kapacitete të kufizuara zjarrfikëse.

4 vitet e para:

- Auditime të sigurisë strukturore nga zjarri;
- Hartim i planit të veprimit për qasje për zjarrfikësit;
- Ndërtimi i një qendre të re të zjarrfikësve;
- Shtimi i pajisjeve, automjeteve dhe dronëve për shfrytëzim nga zjarrfikësit;
- Plan Komunal për Energji & Klimë;
- Auditime për investime në eficiencë energjie në objekte publike dhe kolektive në bashkëfinancim me masat subvencionuese nga niveli qendror;.
- Zgjerim i rrjetit të ngrohjes qendrore për ~40,000 qytetarë;
- Rritje të numrit të parqeve, hapësirave të gjelbra dhe mbjellja e drunjve;
- Ulje e nivelit të ndotjes nga trafiku përmes transportit urban dhe krijimit të lehtësirave në qarkullim për mjetet elektrike;
- Menaxhim i përmirësuar i mbeturinave përmes riciklimit në burim;
- Eliminim deponish ilegale;
- Investime në rrjetin e ujësjellësit për ta parandaluar humbjen e ujit;
- Investim në lidhjen e rrjetit të Badovcit me Ibër-Lepenc;
- Investimi në filtra të rinj për Fabrikën e Ujit në Shkabaj për përpunim adekuat të ujërave atmosferikë dhe funksionalizimin e trajtimit të ujërave të zeza.

Vizioni 2035:

Ajër i pastër, ngrohje e përballueshme/efiçiente, trafik jo-ndotës, gjelbërim i dendur, ndërtesa efikase me energji të ripërtëritshme; kolektorë/impianetet funksionale; menaxhim modern mbeturinash; kapacitete të forta për parandalim/reagim.



Gjendja sot:

Rritje popullsie, shërbime të pamjaftueshme; referim i tepërt në QKUK; digjitalizim i pjesshëm; SISH bazik; shëndeti mendor në primar vetëm këshillim; mangësi në programe për fëmijë/kancer gjiri; varësi nga MSH/IKSHP për shumë shërbime.

4 vitet e para:

- Ndërtimi i QMF-ve të reja në Mati 1, Kalabria/Prishtina e Re dhe Arbëria;
- Modernizim dhe standardizim pajisjesh në të gjitha QMF-të e qytetit;
- Implementimin e respektimit të termineve të kryera përmes sistemit online për mjekun familjar;
- Publikimin e listave të barnave të disponueshme;
- Rritjen e kapaciteteve diagnostike, si imazheri dhe laboratorë në QMF;
- Shtimin e numrit të mamografëve dhe fushata sensibilizuese për kontrolle të rregullta;
- Shtimin e shërbimeve sekondare ambulantore dhe stomatologjike;
- Hartimin e planit për ofrimin e shërbimeve spitalore dhe finalizimin e Spitalit të Prishtinës në bashkëpunim me ShSKUK dhe Ministrinë;
- Rritjen e numrit të ekipeve mjekësore dhe logjistike për vizita në shtëpi;
- Rritja e flotës së autoambulancave dhe numrit të ekipeve urgjente në mënyrë që reagimi të jetë <5 min;
- Programi për shërbime të integruara për grupmoshat 0–6 vjeç, me ekip multidisiplinar, me theks në rritjen e numrit të pediatrëve që shërbejnë në QMF;

- Shërbime këshilluese të shëndetit mendor në QMF dhe Grup Komunal për urgjenca të shëndetit mendor me Policinë.

Vizioni 2035:

Rrjet i integruar primar+sekondar, procese plotësisht digjitale, programe shkollore/edukative, IFH (kontrollat e përgjithshme për fëmijë) funksional, kujdes në shtëpi i zgjeruar.



Gjendja sot:

Pabarazi urbane/rurale; disa shkolla të mbingarkuara; mungesë laboratorësh/teknologjie/hapësirash; lidhje e dobët e profesionale me tregun; digjitalizim pa shkathtësi/mbështetje; rënie sigurie (bullizëm/dhunë); qasje e pamjaftueshme për fëmijët me aftësi ndryshe; mësues të demotivuar; bashkëpunim i dobët me UP; shkollat të shkëputura nga komuniteti.


4 vitet e para:

- Intervenime emergjente në objektet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm (siguri, ndriçim, tualete, kulmë, kanalizim);
- Plan sigurie për shkolla: hyrje të kontrolluara, oborre të sigurt, kamera, raportim dhe menaxhim i dhunës;
- Përfundimi i shkollës në Veternik;
- Ndërtimi i infrastrukturës arsimore në vijë me zgjerimin e lagjeve dhe krijimin e lagjeve të reja;
- Zgjerim i të gjitha shkollave dhe kopshteve ekzistuese; asnjë klasë >25–30 nxënës;
- Ndërtimi i çerdheve publike dhe me bazë në komunitet, të paktën dy për secilën lagje;
- Program i subvencionimit të pagesave për kopshte private;
- Zgjerim i mësimi tërë-ditor pas krijimit të ambientit adekuat që ofron kushte për kurrikulë të pasuruar, me fokus në fushat e kulturës përmes vizitave të organizuara në shfaqje, festivale, program për sport brenda dhe jashtëkurrikular, krijimin e kopshteve të shkollave për mësimnxënie dhe rekreacion, dhe edukim për mirëqenie digjitale;
- Pajisje digjitale të qasshme për të gjithë nxënësit dhe ofrimin e lëndëve zgjedhore për IA, kibernetikë, edukim medial.

- Blerje e instrumenteve dhe pajisjeve laboratorike;
- Planifikim i integruar investimesh për të evituar investimin e dyfishtë;
- Implementimi i politikave për eficiencë energjie dhe panele solare në objektet ekzistuese me dizajn të ri efikas;
- Qasje e plotë universale për persona me nevoja të veçanta; shtim i numrit të stafit mbështetës si asistentë, logopedë, psikologë, pediatër); monitorim i Planeve Individuale të Përparimit dhe vlerësim i përshejtuar për asistim për nevoja specifike të nxënësve;
- Shërbime psikologjike në çdo shkollë dhe fushata sensibilizuese brenda shkollave për destigmatizimin e ndihmës nga psikologu;
- Fuqizim i arsimit dual dhe krijimin e ndërlidhjes me industri kreative;
- Bursa për vajza që vijnë nga familje me vështirësi ekonomike ose rrethana të rënduara sociale;
- Implementimi i programeve kulturore, sportive dhe komunitare në partneritet me Universitetin e Prishtinës, institucione të tjera relevante dhe me artistë;
- Zhvillim profesional për mësues në bashkëpunim ndërmjet DKA dhe MASHTI; fuqizim i Këshillave të Prindërve.

Vizioni 2035:

Mësim tërë-ditor, klasa digjitale, laboratorë modernë, menza me "Kuzhinë Qendrore", ndërtesa efikase me energji të rinovueshme, qasje e plotë për fëmijët me nevoja, shkollë-qendër komunitare, mësues të mbështetur.



Gjendja sot:

Çmime të papërbalueshme pavarësisht ndërtimit masiv; shumica e objekteve pa pranim teknik; ndërtime pa leje nga >46,000 (2015) në ~80,000; stok komunal minimal e i paorientuar socialisht; geto sociale; mungesë politike të banimit dhe të dhënash; koordinim i dobët; menaxhim i dobët i objekteve kolektive (pa këshilla/rregull shtëpiak).

4 vitet e para:

- Njësia e Banimit si koordinator qendror; inventarizim i plotë i pronave dhe sistem monitorimi për shfrytëzimin e tyre;
- Përshejtim i pranimit teknik të objekteve si masë mbështetjeje për banorët; digjitalizim dhe proaktivitet në legalizim; zgjidhje pronësie në zona më pak të urbanizuara me banorët;
- Stok komunal për banim social të përkohshëm (p.sh. shkëmbim i një pjese taksash me banesa me sektorin privat), përzgjedhje e hapur e përfituesve, dhe krijim të një sistemi lidhjeje ndërmjet Komunës dhe grupeve të cënueshme për punësim, themelimin e startups dhe mbështetjeje për kualifikim profesional;
- Program banimi të përbalueshëm: ndërtim e shitje me çmim të përbalueshëm nga Komuna;
- Skema për objekte kolektive: subvencione mirëmbajtjeje, themelim Këshillash Banorësh, grante për krijimin ose zgjerimin e hapësirave të përbashkëta.

Vizioni 2035:

Qasje e dinjitetshme dhe e përbalueshme; të dhëna të sakta; të paktën 500 banesa komunale për strehim të përkohshëm të shpërndara në lagje; ndalim i ndërtimeve të reja pa leje; ulje e stokut ekzistues të paligjshëm; mirëmbajtje/Këshilla/Rend Shtëpiak funksional në çdo objekt.



Arti dhe Kultura

Gjendja sot: Potencial i madh, por pak hapësira, të përqendruara në qendër; pak program komunitar; mungesë strategjie; financim ad-hoc e i politizuar.

4 vitet e para:

- Hapësira multifunkionale komunitare në çdo lagje/fshat; grante për periferi dhe programe jashtë orarit;
- Kartela Kulturore qasje falas dhe me zbritje për të rinj/ pensionistë/studentë/familje me të ardhura të ulëta;
- Rezidenca vjetore për 30 artistë;
- Fond emergjent social për artistët;
- “Arti në Shkollë”: kurse falas arti/muzike/teatri (1–9), rezidenca artistike, klube kreative;
- Artistë të përfshirë në aktivitete në komunitet, administratë, shkollë e qendra të të moshuarve;
- Themelimi i Këshillit të Artit dhe Kulturës i pavarur për vlerësim për dhënien e granteve dhe investimeve;
- Fond Komunal për Inovacion & Krijimtari (art digjital, projekte eksperimentale, arkivim urban);
- Revitalizim hapësirash të braktisura (p.sh. Tulltorja) në qendra kreative;
- Renovim i Bibliotekës Kombëtare;
- Renovim i Teatrit ODA;
- Ndërtimi i Muzeut të Artit Bashkëkohor & Teatrit të ri në ish-Rilindja;
- Ndërtimi i Sallës Koncertale;
- Projektimi dhe nisja e ndërtimit të Teatrit të Operas dhe Baletit, Teatrit të Qytetit, Muzeut të Prishtinës;
- Hartimi i Kalendarit Kulturor dhe rritje kapacitetesh për shfaqje, koncerte dhe festivale.

Vizioni 2035:

Kulturë si e drejtë publike; qasje në çdo lagje; financim strategjik e transparent; industri kreative si motor ekonomik; hapësira publike të gjalla.



Sporti dhe Aktiviteti Fizik

Gjendja sot:


Pa politikë sporti; financim jo transparent; infrastrukturë e përqendruar periferikisht; qasje e pabarabartë, sidomos për vajzat dhe sportet më pak të përhapura; pak programe komunitare; hapësira të paqasshme/pasigurta; shkolla nuk hapen për komunitet; aktivitetet me pagesë; mungon angazhimi për Lojërat Mesdhetare 2030.

4 vitet e para:

- Strategjia Komunale për Sport 2026–2035, në linjë me ligjin/strategjinë kombëtare;
- Rritje buxheti dhe reformim subvencionesh me prioritet për sportin e vajzave, klubet e reja, aktivitetin komunitar; përkrahje strategjike për klube/profesionistë elitare;
- Databazë e talenteve për t'i siguruar mbështetje përgjatë karrierës sportive;
- Lansimi i programit “Sport në Komunitet/Lagje” dhe shtypa për pjesëmarrje aktive në “Sporti në shkolla”;
- Rregullore e re për përdorimin transparent të objekteve dhe sallave të shkollave dhe hartimin e një kalendar digjital publik të termineve për shfrytëzimin e këtyre hapësirave;
- Mirëmbajtje nga Ndërmarrja Komunale e Lagjes;
- Çdo vit: ≥4 hapësira sportive të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, përfshirë dhe zona për të moshuar;
- Ndërtimi i Stadiumit Nacional;
- Renovimi i plotë i Pallatit të Rinisë;
- Investimi në Qendrën e Studentëve, Fshatin Mesdhetar, Pallati “1 Tetori” dhe 12 salla të shkollave;
- Ndërtimi i një sallë të re shumë-sportëshe me konvikt;
- Ndërtimi i një Salle për xhudo;
- Ndërtimi i Pishinës Olimpike.

Vizioni 2035:

Sport për të gjithë; hapësira të qasshme e të sigurta; pjesëmarrje e gjerë e vajzave; klube konkurruese ndërkombëtarisht; trashëgimi e Lojërave 2030 si katalizator i transformimit.



Trashëgimia Kulturore dhe Qendra Historike

Gjendja sot:


Neglizhencë sistematike; ndërhyrje pa kriter; plane të vjetra pa mekanizma mbrojtës; mungesë investimesh lokale; monumente të dëmtuara/pa shenjëzim; pronarë privatë pa mbështetje.

4 vitet e para:

- Integrim i Planit të Konservimit në PZHK dhe dokumentet planifikuese;
- Listë investimesh prioritare; rifunksionalizim ndërtesash me vlerë;
- Rijetësim i lagjeve/rrugëve historike me akses të përmirësuar në hapësira publike;
- Fond i veçantë për mbrojtje/menaxhim të monumenteve;
- Program mbështetjeje për pronarët privatë (restaurim, mirëmbajtje, aktivitete);
- Branding i Qendrës Historike, itinerare të kuruara, shenjëzim tradicional e të dhëna digjitale si dhe përfshirje komunitare;
- Korridor kulturor i hekurudhës: nga Tulltorja te Stacioni i Trenit;
- Ndërlidhje me turizëm dhe industri kreative.

Vizioni 2035:

Qendër Historike e rigjallëruar e integruar në jetën urbane; trashëgimia në harmoni me zhvillimin e ri; ekonomi lokale nga turizmi kulturor.



Gjendja sot:

Shërbime bazike të pamjaftueshme; Qendra për Punë Sociale të mbingarkuara e me staf minimal; mungesë programesh për fëmijë dhe të rinj në vështirësi; barriera për personat me nevoja te veçanta; mbrojtje e pamjaftueshme ndaj dhunës në familje; të moshuar të izoluar; komunitetet rom, ashkali, egjiptas të marginalizuar; mungesë financimi sistemik.

4 vitet e para:

- Shtëpia me Bazë në Komunitet për personat me aftësi të veçanta: themelimi, ndërtimi dhe funksionalizimi i saj në Prishtinë, për t'i dhënë fund varësisë nga komunat e tjera dhe për të siguruar shërbime dinjitoze brenda qytetit;
- Shtëpia për Mbrojtje të Fëmijëve: përfundimi i procesit të ndërtimit dhe funksionalizimit, duke u bazuar edhe në buxhetin tashmë të ndarë në Ligjin për Buxhetin, i cili deri më tani është lënë pa zbatim nga qeverisja aktuale;
- Ristrukturim profesional i Qendrave për Punë Sociale; shtim i stafit, infrastrukturës, pajisjeve dhe përditësim i sistemeve të dhënave;
- Shërbime parandaluese dhe këshilluese për fëmijë, familje, gra, të rinj në situata të cënueshme; shërbime të programeve rehabilituese për të miturit në konflikt me ligjin;
- Kurse profesionale dhe programe punësimi për gratë e papunësuar;
- Plan Veprimi për persona me nevoja te veçanta me buxhet dhe indikatorë të qartë; program punësimi në institucione publike dhe ndërmjetësim për punësime në biznes dhe OJQ; subvencione për pajisje ndihmëse (≥ 200 fëmijë & ≥ 100 të rritur) dhe transport për ata që banojnë në fshatra;
- Model i ri: blerje e shërbimeve nga ofrues të licencuar;
- ≥ 3 kënde lojërash të qasshme për persona me nevoja te veçanta, të bashkëfinancuar me partnerë ndërkombëtarë;

- Programe sociale për angazhim komunitar për të moshuarit; shërbime në shtëpi; dy Qendra Kulturore për të moshuar (Dardania, Bregu i Diellit);
- Qendër e re për komunitetet rom, ashkali, egjiptas me trajnime për punësim.

Vizioni 2035:

Kujdes social parandalues, i qasshëm e profesional; mbrojtje efektive për gra/fëmijë; PAK me shërbime të plota; programe punësimi për integrim të plotë; të moshuar aktivë.



Transparenca dhe Llogaridhënia

Gjendja sot:

Prokurim me marrëveshje të fshehta/keqpërdorime; kontrata me interesa të ngushta; rënie në renditjet e transparencës; konsultime formale e të parrezultate; mungesë dokumentesh integriteti (Plan i Integritetit, Kodi Etik, konflikt interesi, mbrojtje sinjalizuesish); Kuvendi pa mekanizma llogaridhënieje.

4 vitet e para:

Fund praktikave të fshehta; çdo vendim në “dritë të diellit”.

- Publikim i kontratave/buxheteve/vendimeve në formate të hapura (Open Government Program);
- “e-Prishtina” si platformë gjithëpërfshirëse: njoftime, konsultime, projekte në lagje, buxhetim pjesëmarrës.
- Robotë informues me IA për procedurat komunale;
- Konsultime me kohë/feedback të dokumentuar; buxhetim pjesëmarrës & gjinor (pilot në lagje/sectorë); “Forumi i Grave”;
- Vlerësim i Integritetit Komunal; dokumente të reja të integritetit dhe kapacitete zbatimi;
- Mekanizma transparence për Kuvendin (raportim publik për buxhetin, ndërmarrjet, pronat);
- Trajnime dhe hartime të protokolleve për integritetin.

Vizioni 2035:

Qeverisje e hapur me integritet; çdo shpenzim e kontratë e hapur; qytetari bashkërregullon e monitoron; “e-Prishtina” redukton hapësirën për korrupsion; Kuvend me integritet.



Përmbledhje e përgjithshme

Platforma “Prishtina 2035” kthen meritën, ligjshmërinë dhe të dhënat në bosht të qeverisjes; planifikon urbanisht me PZHK/ plane rregulluese e kadastra të riorganizuara; ul ndotjen e rrit reziliencën; rrjetëzon shëndetësinë dhe e sjell afër shtëpisë; modernizon shkollat (mësim tërë-ditor, digjital, efikas energjetikisht); e bën banimin të përballueshëm e të rregullt; demokratizon kulturën dhe fuqizon industrinë kreative; universalizon sportin me trashëgimi nga 2030; rigjallëron trashëgiminë si ekonomi e identitet; forcon mirëqenien dhe hap qeverisjen plotësisht.

105 Lëvizja VETËVENDOSJE!

Hajrulla Çeku